



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. _____ prot

Durrës, më 01. 05. 2020

VENDIM

Nr. 7, datë 01.05.2020

Në mbështetje të ligjit nr. 80|2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë", të vendimit të këshillit të ministrave nr.658, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të statutit dhe rregullores së Universitetit Aleksandër Moisiu dhe urdhërit të Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve nr. 104, datë 30.4.2020 për "Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademi 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID 19", Rektorati në mbledhjen e datës 1.5.2020,

VENDOSI:

1. Të marrë masat për rikthimin në auditorë me datë 1 Qershor 2020, të studentëve të të gjithë cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për përsëritjen e leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike.
2. Ti propozojë Senatit Akademik ndryshimet në kalendarin akademik 2019-2020 si më poshtë:
 - 1 Qershor-21 Qershor, realizimi i përsëritjeve të leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të tretë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të fundit të ciklit të studimeve master.
 - 22 Qershor-28 Qershor, java e përgatitjes për provimet përfundimtare.
 - 29 Qershor-12 Korrik. sezoni i provimeve.
 - 13 Korrik-19 Korrik, zhvillimi i provimeve të mbartura.
 - 20 Korrik-26 Korrik, mbrojtja e temave të diplomave/zhvillimi i provimit të formimit.
 - 27 Korrik-6 Gusht, përmbyllja e dokumentacionit për diplomim për studentët e vitit të tretë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të fundit të ciklit të studimeve master.

- 1 Shtator-28 Shtator, realizimi i përsëritjeve të leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të parë të ciklit të studimeve master.
- 22 Shtator-4 Tetor, java e përgatitjes për provimet përfundimtare.
- 5 Tetor-18 Tetor, sezoni i provimeve.
- 19 Tetor-25 Tetor, zhvillimi i provimeve të mbartura.
- 26 Tetor-1 Nëntor, përmbyllja e dokumentacionit.
3. Të ngarkojë dekanët e fakulteteve për hartimin e orarit mësimor me kapacitet të reduktuar numri studentësh deri me datë 5.5.2020.
 4. Të ngarkojë drejtorët e drejtorive të UAMD, të kryesuar nga Z. Vilson Xhaferraj, të hartojnë dhe paraqesin për miratim rregulloren e brendshme për sjelljen e studentëve në institucion, hyrje-daljet, distancimin social, lëvizjet në institucion dhe higjienizimin periodik të ambienteve deri me datë 8.5.2020.
 5. Të ngarkojë kryesekretaret të administrojnë ndarjen në lista emërore të studentëve që do të ndjekin mësimin në auditorë.
 6. Të vijojë mësimin në distancë për të gjitha ciklet e studimit deri në realizimin e plotë të planit mësimor të miratuar.
 7. Të ngarkojë Dekanët e fakulteteve për planifikimin e punës me stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe për dokumentimin në zyrën e protokoll arkivës së UAMD si dhe pasqyrimin në faqen zyrtare të UAMD.
 8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori i UAMD
 - Zv. Rektorët
 - Dekanët e fakulteteve
 - Drejtorët e drejtorive
 9. Ky vendim i përcillet për shqyrtim Senatit Akademik dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik.

